

Udhëzime të Përgjithshme rreth Politikave të Privatësisë

Hyrje

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në kuadër të mandatit të saj sipas Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, me qëllim të funksionimit dhe krijimit të politikave të saj të privatësisë, në pajtim me rrethanat si dhe bazuar në Ligjin N. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbledh dhe **përpunon** të dhëna personale për kryerjen e detyrave të saj zyrtare të përcaktuara me ligjet në fuqi.

Agjencia përmes këtij udhëzuesi përcakton standardet e sigurisë të përpunimit të të dhënave personale dhe të dhënave tjera të cilat janë të mbrojtura dhe të garantuara me ligjet në fuqi për mbrojtjen e tyre.

Në vazhdim, udhëzimet dhe informacionet e përgjithshme lidhur me përpunimin e të dhënave personale në ueb-faqen zyrtare të Agjencisë, do të jenë të kufizuara për atë që nuk cenohet e drejta e mbrojtjes dhe privatësisë të këtyre të dhënave të cilat publikohen në ueb-faqen zyrtare të saj.

Për më tepër, ueb-faqja zyrtare e Agjencisë përmban referenca të ndryshme të linçeve tjera të internetit, për të cilat duhet respektuar privatësia e tyre, ndërsa politikat e privatësisë vlejné vetëm për ueb-faqen e Agjencisë.

Përndryshe, rregullat dhe udhëzimet rreth politikave të privatësisë së ueb-faqes zyrtare të Agjencisë, mund të përditësohen në vazhdim, varësisht nevojave. Për qëllime të efektivitetit dhe transparencës në raport me opinionin publik, çdo ndryshim/plotësim Agjencia do ta bëjë atë përmes postimit në ueb-faqen e saj zyrtare.

Të dhënat personale dhe ueb-faqja e Agjencisë

Duke aplikuar teknologjinë informative, si një mundësi për informimin e opinionit të gjerë, përmes përdorimit të metodave të ndryshme të qasjes në ueb-faqet zyrtare të institucioneve, ueb-faqja e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit është një mundësi shumë e mirë për informim të opinionit publik me punën e Agjencisë, dhe njëkohësisht mjet shumë i rëndësishëm për komunikim me palë të interesit.

Ueb-faqja e Agjencisë përveç përshkrimit të punës, mandatit të saj, legjislacionit, përmban informacione të rëndësishme që mund të jenë në interes për opinionin e gjerë për punën dhe aktivitetet që Agjencia i bën në vazhdimësi, duke përfshirë publikimin e opinioneve, vendimeve, rekomandimeve, regjistrat e deklaramit të pasurisë, njoftimeve të ndryshme, lajme të ndryshme që lidhen me detyrat dhe përgjegjësitë që Agjencia i ka me legjislacionin në fuqi. Prandaj të gjitha informacionet, dokumentet si pjesë e punës së Agjencisë, të cilat publikohen në ueb-faqen e Agjencisë, bëhen me qëllim të transparencës dhe llogaridhënies së punës së Agjencisë në raport me opinionin, gjithmonë duke respektuar të drejtën e mbrojtjes e privatësisë dhe të dhënave personale sipas legjislacionit përkatës për qasjen në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Informacionet në ueb-faqen e Agjencisë, publikohen për atë që nuk rrezikohet siguria e privatësisë dhe të dhënave personale që janë pjesë e punës së Agjencisë.

Kategoria e të dhënave të publikuara nga Agjencia

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit gjatë kryerje së detyrave të saj zyrtare mbledh të dhëna në formë fizike dhe elektronike, i përpunon ato dhe i publikon në ueb-faqen e saj. Kategoritë

kryesore të të dhënave që Agjencia publikon në ueb-faqen e saj janë: opinionet, vendimet, rekomandimet, regjistrat e deklarimit të pasurisë, njoftime të ndryshme, lajme që lidhen me detyrat dhe përgjegjësitë që Agjencia i ka me legjislacionin në fuqi.

Përpunimi dhe publikimi i të dhënave nga Agjencia

Agjencia me qëllim realizimit të mandatit të vet mbledh dhe përpunojmë të dhëna si:

- emrin dhe mbiemrin e subjektit deklarues, datën e lindjes, numrin personal, gjendjen civile dhe emrin e njërit prind si dhe numrin fiskal nëse e ka;
- emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të familjes të subjektit deklarues, datën e lindjes, numrin personal, gjendjen civile dhe lidhjen me subjektin deklarues;
- adresën e vendbanimit të përhershëm dhe adresat e vendbanimeve të mundshme të përkohshme;
- pozitën aktuale deklaruese dhe funksionet tjera në sektorin publik dhe privat, përfshi periudhën kohore të ushtrimit të funksionit;
- të dhënat mbi pronësinë, bashkëpronësinë apo aksionet, pozitat menaxhuese ose të drejtat e tjera në ndonjë kompani, institucion privat ose ndonjë aktivitet tjetër privat me një përshkrim të aktivitetit, deklarimi i bizneseve pavarësisht statusit të tyre në Agjencinë përgjegjëse për regjistrim të bizneseve si dhe një përshkrim të emrit të regjistruar apo emrit të organizatës;
- të dhënat mbi pronësinë, bashkëpronësinë apo aksionet dhe të drejtat që bizneset ose subjektet e tjera të përmendura në nën-paragrafin 1.5. kanë në një tjetër kompani, institut apo aktivitet privat me përshkrimin e emrit të regjistruar apo emrit të organizatës;
- pronësinë përfituese së bashku me pronësinë apo bashkëpronësinë si dhe kursimet e anëtarëve të familjes;
- të hyrat personale neto për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjellë të hyra personale neto, përfshirë dhe pagesat për udhëtime jashtë vendit të ndara sipas udhëtimeve, si dhe pagesa apo shtesa të tjera të detajuara për pjesëmarrje në, komisione dhe grupe të tjera të ngjashme. Të hyrat për secilin angazhim, deklarohen të ndara;
- pasurinë e paluajtshme, dhe të drejtat reale mbi to duke përfshirë informacionin për sipërfaqen në metra katrorë ose hektarë, sipas rastit, numrin e parcelës, origjinën dhe/ose mënyrën e blerjes apo përfitimit, vitin dhe çmimin e blerjes, dhe pronarin paraprak nga i cili është përfituar;

- pasurinë e luajtshme, përfshirë çdo pjesë të veçantë të pasurisë së luajtshme duke përfshirë informacionin mbi origjinën dhe/ose mënyrën e blerjes apo përfitimit, vitin e blerjes dhe çmimin e blerjes, dhe pronarin paraprak nga i cili është përfituar prona;
- mjetet monetare të gatshme, mjetet monetare të depozituara në llogari rrjedhëse dhe të kursimeve si dhe kursimet dhe interesat e fituara nga depozitat brenda dhe jashtë vendit, përfshirë edhe në valutë të huaj, llogaritë në bankat jo rezidente, dividendat, kursimet nga pjesëmarrja në skemat pensionale në truste apo kursimet tjera për vete dhe anëtarët e tjerë të familjes, vlera e përgjithshme e të cilave tejkalon shumën tremijë Euro (3,000€);
- të dhënat mbi pronësinë, bashkëpronësinë apo aksionet dhe të drejtat që subjektet deklaruese dhe anëtarët e familjes së tyre kanë në një tjetër kompani, institut apo aktivitet privat me përshkrimin e emrit të regjistruar apo emrit të organizatës si dhe investimet në këto aksione;
- lojet dhe vlerat e letrave me vlerë dhe stoqet, duke përfshirë letrat me vlerë të emetuara nga një qeveri e huaj dhe obligacione të korporatave nëse në kohën e deklarimit të pasurive, vlera e përgjithshme e tyre tejkalon shumën tremijë Euro (3,000€);
- borxhet, detyrimet ose garancitë e marra, kreditë dhe huazimet me të cilat deklaruesi është ngarkuar apo i është shuar e drejta në pronësi, posedim apo shfrytëzim të pasurisë së paluajtshme apo të luajtshme vlera e të cilave tejkalon shumën tremijë Euro (3,000€);
- shpenzimet, donacionet dhe të gjitha transaksionet e realizuara gjatë periudhës raportuese vlera e të cilave tejkalon shumën tremijë Euro (3,000€);

Përpunimi i të dhënave dhe publikimi i tyre në ueb-faqen e Agjencisë bëhet për qëllimet si në vijim:

- Njoftimi i opinionit për qëllime të transparencës dhe llogaridhënies në raport me publikun si dhe palëve të cilat janë subjekte të kategorive të të dhënave të deklaruarra;
- Mundësia e qasjes dhe informimit lidhur me zbatimin e ligjit, për efikasitetin dhe efektivitetin e procedurave të punës së Agjencisë;
- Mirëmbajtja, përdorimi apo publikimi i të dhënave vetëm për qëllime të kryerjes së detyrave zyrtare, duke marrë çdo veprim në pajtim me ligjin për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave nga çfarëdo lloj keqpërdorimi të tyre;
- Sigurinë juridike për të dhënat e publikuara në ueb-faqen e Agjencisë, sipas kushteve të përcaktuara me ligj, përveç në rastet kur zbulimi i tyre palëve të treta, të autorizuara me ligj specifik, në këtë rast autoritetet e zbatimit të ligjit (gjykata, prokurori), kur kjo është e nevojshme dhe proporcionale për qëllime legjitime dhe specifike;

- Përpunimi dhe përdorimi i të dhënave zyrtare bëhet vetëm për qëllime të kryerjes së detyrës zyrtare, ndërsa për qëllime statistikore sigurohet mbajtja e tyre me masa mbrojtëse të përshtatshme brenda institucionit;

Të drejtat e palëve në raport me përpunimin

Duke qenë se Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, mbledh dhe përpunon të dhëna në formë fizike dhe elektronike, të gjitha palët të cilat janë të përfshira në të dhënat e përpunuara nga Agjencia, kanë të drejta të bazuara sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kur kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave të tyre personale nga Agjencia për qëllime të kryerjes së detyrës zyrtare dhe atë:

- Të drejtë qasjeje në të dhënat e tyre personale, në çdo kohë, të kërkojnë korrigjimin e përditësimin pa vonesë të të dhënave, nëse ka pasaktësi apo janë jo të plota;
- Të drejtën e fshirjes (“e drejta për t’u harruar”) të të dhënave, të kërkojë që përpunimi të ndalohet në rrethana të caktuara, duke shfrytëzuar të drejtën e kundërshtimit në rrethana të caktuara kur kjo lidhet me një situatë specifike;
- Të drejtën që rastet e mësipërme, kur këto ndryshime kërkojnë, kjo t’iu komunikohet palëve tjera, të cilave u janë zbuluar të dhënat tuaja;
- Të drejtën e ankesës në çdo kohë, nëse besoni të drejtat për mbrojtjen e të dhënave janë shkelur.

Si të ushtroni të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave në Agjenci

Nëse Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përpunon të dhënat tuaja personale dhe dëshironi të ushtroni të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave, ju lutemi na dërgoni një kërkesë me shkrim tek zyrat e Agjencisë, me postë elektronike në : info.apk@rks-gov.net ose në adresën: Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Rr. “Shkodra”, Nr. 6.

Gjithashtu ju mund të kontaktoni edhe Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të APK-së (www.apk-rks.net/index.php/kontakti/#).

Në parim, kërkesat verbale (telefonike ose ballë për ballë) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në Agjenci nuk mund të pranohen, pasi kërkesat e tilla duhet të shqyrtohen dhe analizohen nga Agjencia paraprakisht, me qëllim të identifikimit me besueshmëri të lartë. Përndryshe, kërkesat e tilla duhet të përmbajnë një përshkrim të hollësishëm dhe të saktë të të dhënave në të cilat kërkojë të përdoren. Kur ka dyshime të arsyeshme në lidhje me identitetin e parashtruesit të kërkesave, mund të kërkojë siguri i informacioneve shtesë të cilat i kontribuojnë verifikimit të identitetit të parashtruesit të kërkesës. Në këto raste, të gjitha të dhënat e kërkuara do të përdoren vetëm për të verifikuar identitetin e palëve dhe për qëllime të përdorimit të tyre.